



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 131, Datë 16.08.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË “THE BLUE STAR” SH.P.K., PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GORICË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.747 MW.

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “THE BLUE STAR” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “THE BLUE STAR” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat , “b”, “c”, “e”, “f”), është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” “d”), është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5), është plotësuar tërësisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 2 gërma “a”, (Aktin e themelimit të shoqërisë);
- Neni 9, pika 2 gërma “d”, (Vërtetimin nga Gjykata);
- Neni 9, pika 2 gërma “g”, (Dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti), do të njoftohet subjekti që në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 MW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.